



Newsletter, KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.4 Prill 2019

Index:

Aktivite	2
Aktivite	4
KMD rajonale	6
Poster sensibilizues	8

KOMISIONERI GAJDA I DORËZON KREUT TË KQZ, ZGURI REKOMANDIMIN E EQUINET PËR FUSHATAT ZGJEDHORE



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda zhvilloi një takim me z. Klement Zguri, kryetar i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve. Komisioneri Gajda e informoi kreun e KQZ për angazhimin e Equinet - Rrjeti European i Organeve të Barazisë dhe KMD për të promovuar më tutje "Rekomandimin mbi Luftën kundër Diskriminimit dhe Gjuhës së Urrejtjes në fushata zgjedhore", edhe në vendin tonë! Ndër të tjera, Komisioneri Gajda kërkoi nga ana e administratës së KQZ të bëhej kujdes me vendosjen e qendrave të votimit me aksesueshmëri dhe dosmodoshme për personat me aftësi të kufizuara.

Nga ana e tij, kreu i KQZ, z. Zguri vlerësoi se 10 rekomandimet e EQUINET janë shumë të nevojshme për tu ndjekur nga të gjitha subjektet zgjedhore, sidomos parandalimi i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimi i grupeve vulnerabël gjatë fushatës zgjedhore, si dhe garantoj se parimet kryesore të rekomandimit dhe nevoja për aksesueshmëri të qendrave të votimit për personat me aftësi të kufizuara do të jenë në fokus të punës së Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Gajda falenderoi z. Zguri për gatishmërinë për të harmonizuar rekomandimin e EQUINET në fushatë ndërgjegjëse të KQZ për promovimin e parimit të mosdiskriminimit, të barazisë dhe të tolerancës.

Rekomandim i EQUINET gjendet i plotë në: www.kmd.al

Komisioneri Gajda prezantoi në Kuvend raportin vjetor të institucionit për 2018



Komisioneri Gajda po prezanton në Kuvendin e Shqipërisë Raportin e veprimtarisë vjetore të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2018. *Raporti i plotë mund të gjendet në www.kmd.al*

Komisioneri Gajda në Korçë pranë komunitetit rom dhe egjiptian

Në Ditën Ndërkombëtare të Romëve, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda ishte pranë komunitetit rom në Korçë në një takim informues dhe sensibilizues.

Përfaqësuesit e komunitetit, z. Arben Kosturi dhe Dorin Ciuba i ngritën Komisioneri Gajda dhe zyrës lokale të KMD Korçë një sërë problematikash në lidhje me aksesin e shërbimeve publike në Bashkinë Korçë, çështjen e strehimit dhe arsimin e anëtarëve të komunitetit. Komisioneri Gajda tha se zyra e KMD i ka prioritet shqetësimet e përditshme të



komunitetit rom dhe shumë nga vendimet për Diskriminim janë një realitet që ka vënë para përgjegjësisë institucionet qendrore dhe lokale. Po ashtu, Komisioneri Gajda vuri në dukje nevojën për rrjetëzime të komunitetit rom dhe egjiptian, jo vetëm në nivel lokal dhe kombëtar, por edhe ndërkombëtar. Nevojitet një koordinim më i madh për nxitjen e arsimit dhe punësimit profesional të komunitetit rom.

Gjatë takimit të sotëm, u prezantuan edhe disa kumtesa të dr. Eris Rusi, Prof.Fehmi Xhemi, z. Arben Kosturi dhe Bledi Taho mbi pasurinë e kulturës rome. Përfaqësuesit e shoqatave rome dhe 2 egjiptian nënshkruan një marrëveshje për Rrjetëzimin e shoqatave në qarkun Korçë.



KMD në takimin e III-të të Komitetit Drejtues të Instrumentit Horizontal



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda mori pjesë në takimin e III-të të Komitetit Drejtues të Instrumentit Horizontal, ku temë ishte Luftimi i Diskriminimit dhe mbrojtja e të drejtave të grupeve vulnerabël.

Komisioneri Gajda vlerësoi fazën e parë të projektit të BE Horizontal facility për Shqipërinë, duke vënë theksin për vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e organeve shqiptare të përfshira, si mjet për të arritur standartet më të mira.

Po ashtu, Komisioneri Gajda shprehu gadishmërinë për të bashkëpunuar në fazën e dytë të projektit, sidomos për avancimin e temave të gjuhës së urrejtjes, aspekte të zbatimit të ligjit për minoritete, mbledhja e të dhënave, stastifikave që fotografojnë fenomene në kohë, që ndihmojnë në ofrimin e zgjidhjes së problematikave.

"Mbështetja e Parimeve të Tolerancës dhe Mosdiskriminimit, përfshirë në Promovimin dhe Mbrojtjen e Lirisë së Fesë apo Besimit",

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda është në Vienë për të ndjekur punimet e takimit vjetor të OSBE mbi "Mbështetja e Parimeve të Tolerancës dhe Mosdiskriminimit, përfshirë në Promovimin dhe Mbrojtjen e Lirisë së Fesë apo Besimit", për përfshirjen e shoqërisë civile, arsimin dhe nevojën për veprim konkrete.



KMD mori pjesë në Mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Integritit

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda mori pjesë në Mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Integritit, ku u raportua për rezultatet e zbatimit të Reformës në Drejtësi.

Reforma në Drejtësi dhe Mbrojtja të Drejtave të Njeriut janë 2 prej 5 prioriteteve të rëndësishme ka Shqipëria për Integrimin në Bashkimin Evropian.

“Mbledhja e II-të vjetore e Grupit Këshillimor të Programit të Bashkëpunimit të BE/Coe ROMACTED ”



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi z. Robert Gajda, mori pjesë në mbledhjen e II-të vjetore të Grupit Këshillimor të Programit të Bashkëpunimit të BE/Coe ROMACTED në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përfaqësues të nivelit të lartë të autoriteteve vendore shqiptare, grupeve komunitare të veprimit, shoqërisë civile romë dhe pro-romë, agjencive të zhvillimit dhe komunitetit ndërkombëtar në aktivitetin rajonal të Bashkimit Europian dhe Këshillit të Europës, “Promovimi i Qeverisjes së Mirë dhe Fuqizimit Rom në Nivelin Vendor”.

Projekti Romacted është një projekt i cili ka në fokus përmirësimin e shërbimeve për komunitetin Rom, në të gjitha bashkitë e vendit për shkak të problematikave me të cilat ata përballen siç është strehimi, punësimi, mbrojtja sociale e kulturore e komunitetit.

Marrëveshje Bashkëpunimi KMD-Kolegji Universitar Luarasi

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Kolegji Universitar "Luarasi" nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi, në fokus të së cilës janë shkëmbimet akademike të programeve të përbashkëta të Kërkimit shkencor dhe praktikave profesionale të studentëve në institucionin që promovon barazinë dhe të drejtat e Njeriut, duke luftuar diskriminimin dhe ndërgjegjësuar komunitet.

Komisioneri Gajda dhe rektori Ruka konfirmuan nevojën për të bashkëvepruar dhe shtuar



përpjekjet për të promovuar dhe rritur ndërgjegjësimin në lidhje me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit në nivel shkencor dhe akademike dhe angazhohen të punojnë së bashku në këto aspekte:

- Praktika mësimore për studentët, për t'u njohur me bazën ligjore, raste konkrete në lidhje me problemet që lidhen me diskriminimin
- Aktivitete të ndryshme që lidhen me ndërgjegjësimin për problemet e diskriminimit
- Leksione të hapura që lidhen me çdo çështje diskriminimi.

KMD dhe UNICEF vizitë pune në zyrën rajonale në Korçë



Vizitë e z. Roberto De BERNARDI, përfaqësuesi i UNICEF në Shqipëri, në qytetin e Korçës, në kuadër të mbështetjes së dhënë nga kjo organizatë për Zyrën Rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Ndalesa parë ishte në shkollën 9 vjeçare “Ismail Qemali” në një takim me stafin e mësuesve, nxënësve dhe prindërve të kësaj shkolle.

U diskutuan probleme të ndryshme si bullizmi, përjashtimi i fëmijëve nga edukimi dhe gjetja e instrumenteve për të ndërtuar bashkëpunimin, shkollë-komunitet-institucione.

KMD takim informues me Komunitetin Rom dhe Egjyptian lidhur me të drejtat e komunitetit. UNICEF ka sportuar edhe më parë KMD në nisma për ditët e hapura të antidiskriminimit.

Takim në Drejtorinë Arsimore Rajonale dhe Drejtorinë e Kujdesit Social

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda dhe z. Roberto De BERNARDI, përfaqësuesi i UNICEF në Shqipëri zhvilluan një takim në Drejtorinë Arsimore Rajonale dhe Drejtorinë e Kujdesit Social, që qytetin e Korçës.

Së bashku me drejtorin e institucionit z. Kristaq Grabocka dhe Drejtorin e Kujdesit Social, z. Ilir Zguri, si dhe stafin e Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve u biseduan mbi problematikat e ndryshme që hasin nxënësit e grupeve vulnerabël, plotësimin me mësues ndihmës të shkollave në nevojë në zonat rurale dhe trajtimi i pastrehëve në kushte emergjence në këtë qark.

Këto takime ishin në kuadër të bashkëpunimit dhe mbështetjen e UNICEF për organizimin e Ditëve të Hapura, në shkollat e qytetit dhe adresimin e problematikave për shkeljen e të të drejtave dhe diskriminimit.



Komisioneri Gajda takime me organizatat e shoqërisë civile në Shkodër



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda zhvilloi një takim me Organizata e Shoqërisë civile dhe zyra arsimore Rajonale Shkodër.

Gjithashtu komisioneri Gajda inspektoi shkollën 9-të vjeçare "Iliria" dhe një takim me përfaqësuesit e shoqatës "Për të drejtat e komunitetit rom dhe Egjiptian", si dhe vuri në dukje rëndësinë e zyrës rajonale të KMD në Shkodër, si një antenë në terren për të mbledhur ankesa e shqetësime, promovim të barazisë dhe nxitjen e kulturës së mos diskriminimit.

Takimi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda u pasqyruar në median rajonale Tv1- Channel, Shkodër, gjatë vizitës në terren dhe takimeve me OJQ .

"Panairi i Aftësive", vizitë në Qendrën Shqiptare për Integrimin e Njerezve me Nevoja të Veçanta, në Elbasan.



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda mori pjesë në një aktivitet të mirëorganizuar të Qendrës Shqiptare për Integrimin e Njerezve me Nevoja të Veçanta, në Elbasan.

"Panairi i Aftësive", një event ku të rinjtë demostrojnë talentet e tyre të jashtëzakonshme dhe një moment specializimi dhe integrimi komunitar shumë të domosdoshëm. Më këtë rast komisioneri Gajda shpërndau dhe çertifikatat për të rinjtë me nevoja të veçanta.

Qendra është themeluar 3 vjet më parë nga prinder dhe profesioniste, misioni i se ciles eshte integrimi i njerezve me nevoja te vecanta.



Takim i Kuvendit me 21 institucionet e Pavarura



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda mori pjesë në takimin e organizuar nga Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi me 21 institucionet e pavarura, me temë përmbushja e rekomandimeve të Rezolutave të Kuvendit, statusi i zbatimit të rekomandimeve të Institucioneve të Pavarura adresuar Qeverisë dhe problematika të konstatuara nga Shërbimi i Monitorimit të Kuvendit, gjatë vitit 2018.

Në takim merrnin pjesë edhe Ambasadori i Bashkimit Europian z. Luigi Soreca, Ambasadori i OSBE-së z. Bernard Bochart dhe përfaqësuesja e Zyrës së Këshillit të Europës në Tiranë, znj. Jutta Gutzkow.

Praktika në KMD, fillon faza e parë me studentët e fakultetit Juridik



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda priti në ambientet e institucionit një grup studentësh të fakultetit Juridik, cikli Master, që do të zhvillojnë praktikën për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe të drejtat e Njeriut.

Komisioneri Gajda iu prezantoi zyrën e KMD dhe qëllimin e praktikës në këtë fushë, ku më e rëndësishmja është fuqizimi i kapaciteteve, ushtrimi me çështje konkrete dhe përfitimi i përvojës së trajtimit të çështjeve të Diskriminimit dhe njohja e mekanizmave ligjorë për të mbrojtur të Drejtat në tërësi.



THUAJI JO GJUHËS SË URREJTJES



STOP GJUHËS SË URREJTJES ONLINE

Jeto në harmoni me të tjerët, Respekto! Vlerëso!

RAPORTO ÇDO DISKRIMINIM
ONLINE, NDAL GJUHËN E
URREJTJES



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Kreu i KMD:

Z. Robert Gajda

Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është institucion i pavarur i Republikës së Shqipërisë. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Ai mbështetet nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), e cila ka personelin dhe pajisjet e nevojshme për të mbështetur Komisionerin në përmbushjen e detyrave të ngarkuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010.

Për informacione të mëtejshme mbi aktivitetet:

www.kmd.al

Zyra qendrore e KMD

Rr: Rruga e Durrësit (Ish Ministria e Mjedisit)

Tirana, Albania

Zip Code: 1001

E-mail: info@kmd.al

Tel:

Komisioneri: + 355 4 243 1077

Ankesa: + 355 4 243 1078

Zyra rajonale:

Shkodër: Pranë Bashkisë Shkodër, Rr.13 Dhjetori, Nr.1

Zip Code: 4001

Tel: + 355 4 243 1078

Korçë: Pranë Bashkisë Korçë Rr:28 Nentori Nr.1

Zip Code: 7001

Tel: + 355 4 243 1078